



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:250632
Datë: 28.08.2023
Numri i dokumentit: 04622266

C-IV-14-0633

Ankuesja

N G Gjakovë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 24 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 05 shkurt 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PEJ150-0065, të datës 21 janar 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej: Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme nga AL kërkesa për kompensimin e tri pagave të papaguara në shumë prej 522.36 € (3x174.12 €), nga NSH “Modeli” në likuidim. Ankuesi pohoi se AL me rastin e marrjes së vendimit ka bërë shkelje procedurale ku së pari ka bërë shkeljen e nenit 36.1 të LMD-së nr. 04/L-077 të datës 10 maj 2012, së dyti ka bërë shkeljen e nenit 368 të LMD-së, së treti AL është thirrur në dispozitat e cilat nuk janë në fuqi, së katërti ka shkelur nenin 99 par. 1 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me 1 nëntor 2010 dhe së pesti ka shkelur nenin 2 të Ligjit Kundër Diskriminimit, andaj siç duket dhe AL nuk e ka cekur fare Rregulloren e UNMIK-ut 199/24 dhe Ligjin e Punës nr. 03/L-212. Ankuesi më tej pohoi se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me datë 16 prill 2007, në shkresën drejtuar B G tanimë i ndjerë kanë deklaruar se

pagat që u janë borgj do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Ankuesi i propozoj gjykatës që të aprovohet kërkesa për rishikimin e aktvendimit të AL-së, të AKP-së me nr. të lëndës PEJ150-0065, datë 21 janar 2014 dhe çështja e kërkesës për kompensim borgji të aprovohet në tërësi si dhe të priset vendimi i AL të AKP-së. Në mbështetje të ankesës së saj, ankuesja dorëzoi: vendimin e kundërshtuar dhe njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për Beg Gashi të datës 16 prill 2007.

Me 14 mars 2016, e paditura AKP-ja parashtrori mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar, pasi që ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për të kërkuar pagat e tij brenda periudhës tre vjeçare. Më tej e paditura pohoi se neni 40.1.6.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 mbi AKP-në parasheh që tre pagat e papaguara të punonjësve janë kërkesa prioritare dhe ky nen nuk i njeh ish punëtorëve automatikisht të drejtën për tre paga, por i jep prioritet tre pagave që mund të kenë mbetur të papaguara nga totali i pagave që ndërmarrja nuk u ka paguar punonjësve. Po ashtu e paditura pohoi se ankuesi e konsideron të pabazuar pretendimin e parashtruesit se duhet të zbatohet Ligji Federativ dhe të llogaritet parashkrimi për një afat 10 vjeçar dhe lidhur me këtë thekson se neni 352 i LMD-së dhe Ligji mbi Punën e Bashkuar është i zbatueshëm për këto arsye: 1. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 (neni 1) parashikon se ligji i zbatueshëm në Kosovë është ligji i cili ka qenë në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, 2. Ligji mbi Ndërmarrjet është publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ 77/88 me 31 dhjetor 1988 dhe 3. Neni 608 i Ligjit për Punë të Bashkuar është në pajtim të plotë me Ligjin mbi Ndërmarrjet, prandaj nuk është shfuqizuar dhe ka vazhduar të jetë në fuqi. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së, në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033.

Me 23 mars 2016, mbrojtja e të paditurës iu dorëzua ankuesit. Me 24 mars 2016, ankuesja e pranoi mbrojtjen e të paditurës, por nuk dorëzoi asnjë përgjigje.

Me 04 maj 2023, gjykata nëpërmjet urdhrin kërkoi nga ankuesja që të dorëzoi prova shtesë në mbështetje të ankesës. Me 05 maj 2023, urdhri u pranua nga ankuesja, por asnjë përgjigje nuk u dorëzua në urdhrin e gjykatës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Ankuesja ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PEJ150-0065, datë 21 janar 2014, me të cilin vendim i ishte refuzuar si e pavlefshme nga AL kërkesa për kompensim për tri paga të papaguara, në shumë prej 522.36 € (3x174.12 €) për periudhën 01 mars 2006 deri me 31 maj 2006, nga NSH “Modeli” në likuidim.

Gjykata vlerëson se kërkesa e ankueses për tri (3) paga të papaguara në shumë prej 522.36 € (3x174.12 €) nuk është e mbështetur në prova dhe si e tillë është e pabazuar. Ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante në procedurë të likuidimit, por as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL, me të cilat do të mund të dëshmonte se i njëjti ka ofruar shërbime/punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara. Njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për B G (datë 16 prill 2007) nuk ofron asnjë të dhënë mbi bazën e të cilave do të mund të shqyrtohej kërkesa e ankuesit për borgjin e pretenduar për pagat e papaguara. Ankuesja vetëm e ka caktuar periudhën për të cilën kërkon pagat. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmimeve, pretendimet e saj lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë kërkesa për paga është refuzuar si e pabazuar. Për më tepër ankuesja ka dështuar që të parashtrtojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas mbrojtjes së të paditurës dhe urdhrin të gjykatës.

Kërkesën për 3 paga të papaguara në shumë prej 522.36 € (3x174.12 €), gjykata e gjen si të pabazuar edhe për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në (nr.04/L-034), neni 40.1.6.1, i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat, por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksat gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar